

KËRKIME GJUHËSORE

Meli SHOPI

D. HIMCI

DYGJUHËSIA DHE DYKULTURËSIA E ROMËVE NË STUDIMET E DR. MARSEL KURTIADË

Romët përbëjnë një bashkësi apo grupe kulturore gjuhësore¹. Duke hyrë në përbërjen e popullit shqiptar, ata janë asimiluar me shumicën e popullsisë vendase. Vlerësimi i tyre është mbështetur në të dhënat e ndryshme të zyrave të gjendjes civile, si dhe nga verifikimet në terren. Pavarësisht nga përshtatësia e tyre etnike, ku përfshihen edhe grupe të tjera të popullsisë, gëzojnë administrativisht nënshpëtimin shqiptarë, duke zënë një vend të konsiderueshëm në këtë shoqëri. Po cila është origjina e tyre? Jo të gjithë pajtohen me origjinën e romëve². Disa thonë se ata janë nga Egjipti. Disa të tjerë thonë se ata janë racë e pastër indiane. Të përbërë nga tri fise: kabuxhinj, meçkarë, çergarë, ata janë të shpërndarë në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Por diçka duhet sqaruar; nuk duhen ngatërruar emërtimet e fiseve. Çështja rome ngelet midis diskutimeve, pasi nuk është trajtuar në nivelin historiko-shkencor sa e popujve të tjerë. Të studiosh duke u mbështetur në fakte e argumente konkrete në lidhje me këtë problem është një punë sa e vështirë aq edhe e vyer. Problemi më thelbësor qëndron në analizën e rrethanave apo kushteve ku jetojnë e vepron kjo bashkësi, se kur e flet gjuhën e vet, veçorinë etnokulturore të saj, por edhe duke parë veçorinë dalluese në lidhje me bashkësitë e tjera. Një nga treguesit themelorë për përkatësinë e një popullsie është edhe gjuha. Nga studimet e bëra deri tani del se gjuha rome ose *romishtja* paraqitet si një larmi varietetesh dialektore e të folmesh e të flasësh për unifikim të plotë të trajtave dialektore të kësaj gjuhe nuk është i arritshëm, aq më tepër i dëshirueshëm, sidomos në kushtet e shpërndarjes së kësaj popullsie në Ballkan e në shtete të tjera. Por, megjithatë nga studimet e bëra del se këto variante të të folurit, duke ruajtur karakterin e tyre, arrijnë komunikimin brenda bashkësisë. Edhe pse me ndryshime dialektore, romët kudo në botë flasin gjuhën e tyre. Ky është elementi që i mban ato në një bashkësi. Gjithashtu, nuk mund të flitet më, për një jetë endace apo gjysmendace, si dikur. Megjithatë sot në renditjen e studimeve të ndryshme për gjuhë të ndryshme të botës shtohet dhe një literaturë jo e pakët në analizën dhe interpretimin e gjuhës dhe kulturës rome. Sidomos kohët e fundit, ne zotërojmë materiale të mirëfillta shkencore, gjuhësore, por edhe kulturore që i përkasin studiuesve shqiptarë si: Prof. M. Samara, Prof. R. Zemon (për ballkano-egjiptianët) si dhe Prof. M. Kurtiade, E. Marushiakova, V. Popov, Vania de Gila-Kochanovski, me origjinë rome etj.

Pra, njëri nga këta studiues që mbahet si një nga ekspertët më të mëdhenj të kulturës dhe qytetërimit është Dr. M. Kurtiade. Ai i përket bashkësisë rome me

¹ Atlasi Gjeografik i Popullsisë së Shqipërisë, struktura etnike e fetare, 2006, f. 98.

² Etnonimi-Romë-vjen nga Rromba (Rdomba-ind i pastër) që do të thotë artist. (cit. nga studimet e dr. M. Kurtiade).

originë nga Greqia. Ka lindur në Francë, ku përfundoi studimet për letërsi ku ka mbrojtur dhe doktoraturën në këtë fushë. Si themelues dhe kryetar i gjuhës rome në Institutin Kombëtar të Parisit për gjuhët orientale dhe të qytetërimit, ai është ndër brezat e parë të profesionistëve për interpretimin e gjuhëve rome, dhe jo vetëm kaq, por edhe një ndër specialistët më të mëdhenj të letërsisë, kulturës dhe qytetërimit. Studiuesi e ka filluar punën e tij qysh me zbulimin e dokumenteve të para mbi origjinën dhe lëvizjen, shpërndarjen e romëve nëpër botë nga India, për të cilët ekzistojnë dokumente historike nga periudha e shek. 15-të deri në 17-të. Se si kanë arritur romët të shpërngulen nga atdheu i tyre i parë, kushtet e rrethanat që i detyruan të largohen, persekutimet ndër vite, me emërtimet e ndryshme në vite të ndryshme etj., nuk janë objektiv i artikullit tonë, prandaj nuk do të ndalemi në analizën e tyre. Ndoshta në një artikull tjetër do të jenë në qendër të studimit. Në vijim do ta shohim këtë bashkësi në kushtet e dygjuhësisë në vendet ku ato janë përqendruar dhe përshtatur me popullsinë vendase. Një gjë duhet të kemi parasysh që midis çështjeve të trajtuara në këtë artikull nuk duhet të ngatërrohet çështja e bashkësisë egjiptiane ose siç e quan dr. Rubin Zemon³, *ballkano-egjiptianët*, me bashkësinë rome. Gjuha rome ka ardhur bashkë me romët nga India dhe që andej u përhap në tërë botën bashkë me ta. Të gjithë romët njihen nga larg apo nga afër falë gjuhës rome. Por kjo nuk do të thotë që romët kanë mbetur të mënjeluar në bashkekzistencën me popullsinë vendase. Në këtë bashkekzistencë ato jo vetëm kanë jetuar dhe janë përshtatur, por përkatësisht kanë hyrë dhe në bashkëmarrëdhënie gjuhësore, kulturore e jetësore. Pra, kjo popullsi ka jetuar e jeton në kushtet e dygjuhësisë dhe raportet midis të folurit dhe të shkruarit janë studiuar në mënyrë të veçantë, duke e parë gjuhën si studim me të vërtetë shkencor e jo për ta parë atë si përvetësohet. Bashkëjetesa e shumë kodeve gjuhësore, gjuhëve apo regjistrave, bazë për formimin e identitetit, është një faktor pasurimi atëhere kur folësi mbetet mjeshër i përdorimit të tyre, duke shprehur në këtë mënyrë ngjyrimet në mendimin e tij si lojë me fjalët; por ajo mund të shndërrohet në një faktor varfërues dhe veçse i detyruar, nëse folësi nuk mund të shprehë lirisht për të shprehur idetë e veta me anë të kodeve të zgjedhura prej tij, që i ka dashur vetë t'i përdorë, edhe pse nuk i njeh ato. Kodet janë për pasojë shumë të specializuara në fusha të caktuara dhe pamjaftueshmëria e tyre e pengon folësin, aq sa në vend të një burimi që nxit mendimin, kjo pasuri e gjymtuar bëhet pengesë që e ndalon atë të përshtasë kodin e tij ndaj nevojave për t'u shprehur. Duke u nisur nga këto analiza dr. M. Kurtiade analizon funksionimin e regjistrave të gjuhës në një shoqëri rome, rrethuar nga një tërësi gjuhësh tipike. Dhe për këtë ai merr si shembull mjedisin e tij rrethues, ku ndërthuren familjet rome të Tiranës, kushërinjtë e jugut, me një përdorim pak më ndryshe nga kryeqyteti, aleatë që kanë ardhur nga grupe të tjera (çergarë ose kabuxhinj), të martuar me fqinjët shqiptarë, po ndonjëherë edhe sllavë ose të paktën romët e huaj me gjuhë sllave, p.sh. të ftuarit kosovarë apo bullgarë etj. pa folur më për vizitat e pjesëtarëve të

³ Kjo është një çështje më vete, dallimi i egjiptianëve nga romët. Për këtë R. Zemon, është një ndër studiuesit që ka punuar për gjuhën dhe kulturën e bashkësisë egjiptiane.

DYGGJUHËSIA DHE DYKULTURËSIA E ROMËVE NË STUDIMET E DR.
MARSEL KURTIADË

familjes që punojnë në Greqi. Së pari, flitet për një gjuhë indo-ariene, origjinale me Veriun e Indisë (Lugina e Gangut). Ajo është çrrënjëzuar disa herë (në fillim nga Mahmudi i Gaznit në fillim të shekullit 11-të), me trauma të mëdha, humbje dhe nga ana tjetër përballja me realitetet e tjera. Kjo gjuhë gjendet në një përdorim të vazhdueshëm që prej 1000 viteve më parë, ndërkohë që gjuhët e emigracionit zhdukeshin me një rregull të përgjithshëm nga tri brezat në Europë. Romët janë të paktën përdorues të dy gjuhëve, gjë që lejon kalimin e strukturave të ndryshme të jashtme në gjuhën rome, ku disa divergjenca lokale dhe elemente të gjuhës rome u zëvendësuan nga ekuivalentë vendas dhe për shkak të problemeve që dalin në çastin e ligjërimit gjatë ndërkuptimit. Këto vështirësi nuk përbëjnë dhe nuk kanë lidhje me ndryshimet dialektore, por lidhen me braktisjen e një pjese të burimeve gjuhësore të romishtes nga ndikimi i huaj. Sa më e madhe të jetë braktisja, akoma më i vështirë bëhet komunikimi, pa u formuar “dialektet” që fliten (bëhet fjalë për elemente që mungojnë, por fenomeni ndodhi më vonë në gjuhën rome). Siç e përmendëm edhe më lart duhet treguar kujdes në emërtimet e fiseve të romëve. Në njërin nga këto fise futen edhe *meçkarët* ku folësit me variantet gjuhësore navigojnë, sidomos në gjuhën e folur. Folësi më i thjeshtë i këtij fisi, njerëzit më të moshuar kanë një theks në atë lloj të foluri që e bën atë të quhet p.sh. në qytetin e Tiranës, “*tironës*”. Në Tiranë kemi të bëjmë me një përdorim intonacioni dinamik, një leksik specifik e një numër shprehjesh komike që i përdorin deri fëmijët. Folësit e jugut nuk bëjnë pjesë në ndërtimin e këtij sistemi të regjistrave që përbëjnë identitetin shumëgjuhësh të folësit *meçkar* të Tiranës. Të rrallë janë ato që bëjnë pjesë në të folurin e shqipes standarde. Zyrtarisht mbetet forma kryesore e komunikimit, por kemi të bëjmë me shprehje moderne të marra nga fjalori i mediave ose nga politika etj. dhe shumë faktorë të tjerë të jashtëm. Pavarësisht, ruajtjes së gjuhës nga shumë folës romë, kemi të bëjmë me një ekspresivitet të veçantë. Është interesante të zbulojmë se femrat janë më të afta se meshkujt. Kemi përdorime të ndryshme në gjuhë të ndryshme të një fjale. Si vazhdimësi e kontakteve të ndryshme dhe të rastësishme të realizuara nëpërmjet udhëtimeve, vëmë re disa romë që përdorin si dëshirë për pasurimin gjuhësor njësitë më të vogla gjuhësore të harruara nga variantet e gjuhës shqipe. Në disa raste kjo mund të bëjë problem kur fjala ka ngarkesë emocionale, pra përdoret me ngjyrim dhe jo në kuptimin e parë leksikor. Një tjetër seri problemesh shfaqen në nivelin e morfologjisë, në momentin, kur një fjalë karakteristike e një folësi ndërthuret me një tjetër. Një formë e tillë dialektore, e konsideruar e vlerësuar mund të ndikojë në përdorimin e romishtes. Edhe leksiku është i prekur nga huazimet, internacionalizmat pak a shumë të integruara. P.sh. rasti i përdorimit me “*ju*” është e çuditshme në përdorimin e përbashkët. Folësit zbulojnë në maksimum këto burime të ndryshme me forma të shumta stilistikore. P.sh. në raportin me gjuhët më të shumta kemi shembuj me citime të shumta: *një rrugë e dy punë*. E njëjta shprehje mund të jetë e mundur edhe në gjuhën rome. Në vend të vetës së parë në shqip: “*Nuk jam prej atij katundi*”- në gjuhën rome do të kombinonte më shumë në vetën e tretë: “*Nuk është ai prej atij katundi*”. Në këtë rast nuk shohim apo të

kuptojmë shfaqjen e një elementi të huaj. Një numër i madh shprehjesh mund të citohen ashtu si duhen vetëm në gjuhën origjinale. Disa prej tyre duhet të qëndrojnë vetëm në *romishte* përndryshe humbin kuptimin. Kalimi në gjuhën shqipe mund të ketë funksione të tjera, ku mund të shprehet ironia apo dhe deri në sharje etj. Por midis të tjerave mund të theksohet fakti se folësit nuk ngurrojnë të përdorin edhe fjali të plota nga gjuhë të tjera, gjë që çon në një përhapje të gjuhëve të huaja. Është e rëndësishme të nënvizohet fakti se në fushën informative, gjuha shqipe është më e përdorshme në kushtet e ekzistencës së pranishme të romëve të huaj. Ekzistojnë situata ku gjuha rome përdoret vetëm si në rastin e proverbeve, propozimet e martesave, me pjesët rituale të tyre. Kjo analizë e praktikës shumëgjuhëshe tregon se kombinimet me anë të kodeve apo shenjave gjuhësore nuk duhet të konsiderohen gjithmonë si provë e paaftësisë gjuhësore, por si një shprehje e një loje, zhvilluese ndërmjet shumë lloje regjistrash. Kodet janë të specializuara në fusha të caktuara dhe kjo gjë e shtyn folësin të përshtasë kodin e tij nevojave të shprehësisë.

Rastet e përdorura të kësaj analize u morën si shembuj romët e Ballkanit, sepse siç i përcakton edhe studiuesi përbëjnë një nga rastet më të përdorura të shoqërisë njerëzore, por realizimi i tyre është i mundur vetëm në një shoqëri të çliruar nga kuptimi “*i luftës së gjuhëve*” dhe secili anëtar i shoqërisë inkuadrohet në situata shumëgjuhëshe. Romët mund të shfrytëzojnë gjuhën e tyre dhe si mjet për vetizolim gjatë kontakteve me bashkësinë rrethuese, kur nuk duan të jenë të kuptueshëm. Një rom mund të pozicionohet vetëm në raport me familjen dhe brenda saj. Ai nuk është as i njohur apo i rinjohur si individ, por njihet në bazë të situatës që e përcakton atë nëpërmjet fisit ku ai bën pjesë. Nëse fisi është i njohur, edhe individi qëndron në konsideratën e të gjithëve. Përsa i përket jetës sociale të gjithë romët, pavarësisht kujt fisi i përkasin e organizojnë sipas ligjeve të veta të traditës së trashëguar me ëndrrat për të ardhmen. Familja nuk është vetëm e rëndësishme për individin dhe vendimtare për drejtimin e tij, por është gjithashtu një element thelbësor i organizimit shoqëror. Bashkimi social elementar nuk është familja e ngushtë apo e vogël, vetëm me prindërit dhe me fëmijët, por familja e gjerë, e zgjeruar. Disa familje të vogla që përbëhen vetëm nga prindërit dhe fëmijët, janë mbledhur së bashku për të formuar fisin. Në një formë të jashtme apo të brendshme, çdo gjë është e përbashkët midis familjeve, siç janë paratë, ushqimi, veshja, banesa. Martesa është e rëndësishme për individin: fëmija edhe pse duhet shumë nga prindërit, nuk është asgjë nga ana sociale në krahasim me “adoleshentin”, i cili përfshihet në botën e të rriturve dhe më pas shndërrohet në *Rom*, pasi martohet. Martesa mund të kurorëzohet plotësisht pas lindjes së fëmijës së parë. Pra, është fëmija i parë dhe jo martesa ajo që formon familjen. Shkëmbimi i parave nuk ka të bëjë me blerjen. Një vajzë me sjellje të mirë, e edukuar, punëtore madje sot shihet edhe deri-diku sa shkollë ka, (flitet për kohët e sotme), e cila vjen nga një familje me *emër*, meriton t’i jepet një shumë e madhe parash për edukimin e mirë që familja i ka dhënë dhe kjo familje e meriton këtë shumë për vetë faktin se po humbet një vajzë plot vlera. Bëhet fjalë për diçka më të rëndësishme se sa një kompensim simbolik në krahasim me humbjen e vajzës nga fisi i saj. Një

DYGJUHËSIA DHE DYKULTURËSIA E ROMËVE NË STUDIMET E DR.
MARSEL KURTIADË

rregull i tillë u lejon disa fiseve të kenë marrëdhënie të privileguara ndërmjet tyre. Martesa shfaqet në këtë mënyrë si një fenomen kolektiv sesa një fenomen individual, si një pakt i vërtetë social midis grupeve. Përsa i përket organizimeve sociale romët formojnë një shoqëri plotësisht të strukturuar, ato janë të lidhur nëpërmjet lidhjes së gjakut, duke formuar në këtë mënyrë një shoqëri me strukturën e saj të plotë, me traditat, zakonet dhe me ligjet që e përbëjnë atë prej shekujsh. Romi ka një karakteristikë të veçantë që lidhet me faktin se ai pranon ekzistencën e tjetrit që është i ndryshëm nga ai dhe pa krijuar hierarki, gjithashtu pa gjykuar një jorom, i cili nuk ka të njëjtat besime dhe nuk bën të njëjtën jetë. Toleranca është pa kufi ndaj të tjerëve, për sa kohë që tjetri nuk kërkon të plagosë vlerat thelbësore të romit. I vetmi element i pandashëm është familja me fëmijët e pamartuar dhe bashkëpunimi në organizimin ekonomik i bën ata të fuqishëm dhe lidhja midis anëtarëve qëndron më e fortë midis tyre. Në jetën shoqërore një rom ndihet i barabartë, sikur ka të njëjtin gjak me një jorom. Pra, ndjesia e përkatësisë në të njëjtën kategori njerëzish është më e fortë se sa ndryshimet që i ndajnë ato. Distanca gjeografike nuk ka shumë rëndësi. Ajo që i bën ato të veçantë është udhëtimi i gjatë që romët bëjnë në kërkim të një mënyre jetese sa më të qëndrueshme, në kërkim të martesës, të familjeve të ndryshme, të familjeve të nderuara, etj. Një rom që kërkon t'u shmanget normave arrin të ndalohet nga grupi, nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe dënohet për këto veprime. Ai nënvlerësohet plotësisht dhe nuk respektohet si më parë. Në përshtatje me mjedisin ku ndodhen romët, përdorin dy emra karakteristike (tjetër e veçantë e tyre): njërin për të huajt dhe tjetrin për bashkësinë e vet.

Dhe së fundi romët në përgjithësi kanë një filozofi të vetën: *Ditën e sotme e jetojmë, sikur është e fundit* që do të thotë e gëzojmë me të gjitha të mirat që kanë apo fituar, duke mos hequr dorë nga vlera më e madhe që trashëgojnë: muzika. Ato dallohen si virtuozët më të mëdhenj më të mëdhenj të muzikës kudo që ndodhen nëpër botë. Mënyra e organizimit të marrëdhënieve midis fiseve dhe njerëzve me të cilët ato mundohen të drejtojnë në jetën e përditshme, i bën romët shumë herë të tregohen të kujdesshëm edhe në përdorimin e fjalorit, duke iu përshtatur mjedisit në të cilin ato punojnë e jetojnë. Gjuha e tyre përfaqëson një pasuri të jashtëzakonshme dhe një diversitet shumë të madh gjuhësor që u formua qysh me fillimin e historisë së popullit rom. Territori i këtij populli nuk ka kufij, ata janë të pranishëm në të gjitha krahinat e Shqipërisë e kudo. Gjuha me të cilën ata përfaqësohen është studiuar nëse kjo gjuhë ka kaluar në gjuhën e shkruar. Kultura që përcjellin ato përmes kësaj gjuhe është e veçantë jo vetëm brendapërbrenda bashkësisë, por edhe me popujt fqinjë apo vendas ku ato janë përshtatur.

BIBLIOGRAFI

Shënimi: I gjithë materiali është ndërtuar mbi studimet e bëra nga dr. Marsel Kurtiade.

- M.Courthiade, *Prejardhja e kombit rom: kronika e legjenda*, Buletini i Qendrës së Dokumentacionit për të drejtat e njeriut, Tiranë 2002, nr. 3.
- M.Courthiade, *Bilinguizmi dhe dykulturësia e popullit rom*, INALCO, 2002.
- M.Courthiade, *Politika gjuhësore e një minoriteti kombëtar me vendndodhje të shpërndarë në shtete të ndryshme, rasti i gjuhës rome*, INALCO, Romani Baxt.